Subvencione dhe Transferet		-	-	-	-	-
Investimet Kapitale		-	-	-	-	-

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

<b>Raport i pagesave sipas programeve</b>	0	0	0	0	0	0
0	0	0	0	0	0	0
Përshkrimi	shën.	Kujdesi shëndetësor	Kulturë, rini dhe sport	Arsim dhe shkencë	Gjithsej Pagesat	Gjithsej Pagesat
a	0	l	m	n	o=l+m+n	p=f+k+o
0	0	0	0	0	0	0
<b>Gjithsej Pagesat</b>	<b>1+2+3+4</b>	<b>220,508</b>	<b>55,528</b>	<b>501,217</b>	<b>777,253</b>	<b>1,759,648</b>
0	0	-	-	-	-	-
<b>Pagesat nga Granti i Përgjithshëm</b>	<b>1</b>	<b>214,068</b>	<b>55,528</b>	<b>500,527</b>	<b>770,123</b>	<b>1,726,356</b>
Rrogat dhe Pagat	0	89,778	32,349	250,310	372,436	664,284
Mallrat dhe Shërbimet	0	13,836	5,814	33,301	52,951	134,289
Shpenzimet Komunale	0	11,491	-	11,170	22,661	27,486
Subvencione dhe Transferet	0	2,350	-	5,000	7,350	14,791
Investimet Kapitale	0	96,614	17,365	200,747	314,726	885,505
0	0	-	-	-	-	-
<b>Pagesat nga të hyrat vetanake 2010</b>	<b>2</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>2,767</b>
Rrogat dhe Pagat	0	-	-	-	-	-
Mallrat dhe Shërbimet	0	-	-	-	-	1,957
Shpenzimet Komunale	0	-	-	-	-	810
Subvencione dhe Transferet	0	-	-	-	-	-
Investimet Kapitale	0	-	-	-	-	-
0	0	-	-	-	-	-
<b>Pagesat nga të hyrat vetanake te bartura 2009</b>	<b>3</b>	<b>6,440</b>	<b>-</b>	<b>690</b>	<b>7,130</b>	<b>30,525</b>
Rrogat dhe Pagat	0	-	-	-	-	-
Mallrat dhe Shërbimet	0	-	-	690	690	1,993
Shpenzimet Komunale	0	-	-	-	-	-
Subvencione dhe Transferet	0	-	-	-	-	-
Investimet Kapitale	0	6,440	-	-	6,440	28,532
0	0	-	-	-	-	-
<b>Pagesat nga Grantet e përcaktuara</b>	<b>4</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Rrogat dhe Pagat	0	-	-	-	-	-
Mallrat dhe Shërbimet	0	-	-	-	-	-
Shpenzimet Komunale	0	-	-	-	-	-
Subvencione dhe Transferet	0	-	-	-	-	-
Investimet Kapitale	0	-	-	-	-	-

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

---

**Raport i Pranimeve sipas Programeve**

Përshkrimi	Kodi ekonomik	Administrata dhe personeli	Buxhet dhe financa	Shëndetësi	Gjithsej Pranimet
a		b	c	d	f=b+c+d+e+ ....
<b>Gjithsej Pranimet</b>					
		<b>24,477</b>	<b>16,799</b>	<b>260</b>	<b>41,536</b>
Taksa nga regjistrimi i automjeteve	50001	3,380	-	-	3,380
Taksa nga ndërrimi i destinimit të tokës	50012	4,679	-	-	4,679
Taksa nga çertifikatat e lindjes	50013	1,102	-	-	1,102
Taksa nga çertifikatat e kurorëzimit	50014	308	-	-	308
Taksa nga çertifikatat e vdekjes	50015	30	-	-	30
Taksa nga çertifikatat tjera të ofiqarisë	50016	1,577	-	-	1,577
Taksa nga verifikimi i dokumenteve	50017	865	-	-	865
Taksa nga fotokopjimi i dokumenteve	50018	47	-	-	47
Taksa të tjera administrative	50019	2,398	-	-	2,398
Taksa e pjesëmarrjes në tender	50020	7,752	-	-	7,752
Taksa për shtetësi	50025	1,373	-	-	1,373
Licenca për shërbime profesionale	50206	100	-	-	100
Qiraja nga objektet publike	50408	840	-	-	840
Participimet	50409	26	-	260	286
Tatimi në pronë	40110	-	10,758	-	10,758

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

**Pagesat nga Fondi i Përgjithshëm**

		<b>Klasifikimi Ekonomik</b>				
		Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet & transferet	Shpenzimet kapitale
<b>Klasifikimi Funkcional</b>						
	Mbrojtja Sociale					
	Shërbimet e Përgjithshme Publike					
	Mbrojtja					
	Rendi dhe Siguria Publike					
	Çështjet / Marrëdhëniet Ekonomike					
	Mbrojtja e Mjedisit					
	Çështjet e Banimit dhe Komunitetit					
	Shëndetësia					
	Rekreacioni,kultura dhe Religjioni					
	Arsimi					
	<b>TOTALI</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Pagesat nga Fondi i Donatorëve**

		<b>Klasifikimi Ekonomik</b>				
		Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet Komunale	Subvencionet & Transferet	Shpenzimet Kapitale
<b>Klasifikimi Funkcional</b>						
	Mbrojtja Sociale					
	Shërbimet e Përgjithshme Publike					
	Mbrojtja					
	Rendi dhe Siguria Publike					
	Çështjet / Marrëdhëniet Ekonomike					
	Mbrojtja e Mjedisit					
	Çështjet e Banimit dhe Komunitetit					
	Shëndetësia					
	Rekreacioni,kultura dhe Religjioni					
	Arsimi					
	<b>TOTALI</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

---

**Neni 12. Numri i punëtorëve**

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit 03/L-177	Nr aktual i punëtorëve në fillim të 2010		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2010	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Zyra e Kryetarit		3		6	
Administratë dhe personel		26		25	
Buxhet dhe Financa		4		6	
Administrata shëndetësore					
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural		2		5	
Planifikimi urban dhe mjedisi		3		4	
Shërbimet e kujd. primar shëndetësor		18		19	
Shërbimet sociale		3		4	
Kulturë, rini dhe sport		10		9	
Arsimi (Administrata)		2		2	
Arsimi fillor		77		77	
Arsimi i mesëm		7		10	
Arsimi parafillor		2		2	
Prokurimi					
Shërbimet publike dhe mbrojtja civile		8		9	
Zyra për kthim dhe komunitete		3		4	
		168		182	

## **IX**

**Neni 18, Ligji Nr 03/L-221.**

**Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2009**

<b>Nr</b>	<b>Rekomandimi ose gjetja</b>	<b>Veprimi i ndërmarrë ose propozuar</b>	<b>Afati i zbatimit</b>	<b>Efekti</b>
-----------	-------------------------------	--	-------------------------	---------------

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

---

**SHTOJCA 1**

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**

**LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

**Komuna e Novobërdës, Republika e Kosovës.**

**Letër për Menaxhmentin për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

I nderuar Ztr. Bajrush Ymeri, Kryetar i Komunës së Novobërdës

Në planifikimin dhe kryerjen e auditimit të pasqyrave financiare të Komunës së Novobërdës (më poshtë të referuar si “Komuna”) për fund vitin 31 Dhjetor 2010, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, për të cilat ne kemi lëshuar raportin tonë më datë 3 Qershor 2011, ne kemi shqyrtuar sistemin e kontroleve të brendshme dhe të kontabilitetit në mënyrë që të përcaktojmë procedurat tona të auditimit me qëllim të shprehjes së opinionit për pasqyrat financiare, dhe jo me qëllim të përcaktimit të përshtatshmërisë së kontroleve të brendshme për qëllime të menaxhmentit. Një shqyrtim i këtillë jo domosdoshmërisht do të zbulojë të gjitha çështjet e kontroleve të brendshme të cilat mund të jenë mangësi materiale sipas standardeve të përcaktuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.

Dobësitë në kontrollet e brendshme dhe çështjet tjera të kontabilitetit që ne kemi vërejtur gjatë procedurave tona të auditimit, janë përfshirë në këtë letër. Dobësitë tjera në sistemin e kontrollit të brendshëm mund të ekzistojnë dhe ne mund të mos i kemi vërejtur gjatë auditimit tonë. Gjithashtu, ne kemi përfshirë komentet, të cilat edhe pse nuk konsiderohen dobësi të kontrollit të brendshëm, paraqesin çështje që duhet marrë parasysh.

Ne do të donim të shfrytëzojmë rastin të falënderojmë drejtuesit e komunës dhe stafin për bashkëpunimin dhe ndihmën e ofruar gjatë auditimit.

Ky raport ka për qëllim të vetëm të informoj dhe të përdoret nga menaxhmenti i komunës dhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe nuk është drejtuar dhe nuk duhet të përdoret nga dikush tjetër përveç palëve të specifikuar.

Ne do të jemi të kënaqur të diskutojmë më tej këto komente me ju, dhe nëse ekziston nevoja, t’u ndihmojmë juve në implementimin e cilit do prej rekomandimeve.

Me respekt,

Deloitte Kosova Sh.p.k.  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
3 Qershor 2011

**PËRMBAJTJA**

1.	PËRCJELLJA E ÇËSHTJEVE TË NGRITURA NË VITET PARAPRAKE .....	37
2.	ÇËSHTJET E IDENTIFIKUARA GJATË AUDITIMIT TË VITIT AKTUAL .....	43
2.1.	RAPORTIMI FINANCIAR.....	43
2.1.1.	DIFERENCAT NË MES TË PASQYRAVE DHE SHËNIMEVE NË PASQYRA .....	43
2.2.	TË HYRAT .....	45
2.2.1	SHUMAT MBI 10 EURO JANE MBLEDHUR SI PARA TË GATSHME NGA ZYRTARI I TË HYRAVE I KOMUNES.....	45
2.2.2.	MUNGESA E DOKUMENTACIONIT LIDHUR ME TË HYRAT PER ÇERTIFIKATAT E LESHUARA TË REGJISTRIMIT CIVIL NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	46
2.2.3.	MUNGESA E DËSHMIVE TË MJAFTUESHME TË MBAJTURA NGA DEPARTAMENTI I URBANIZIMIT DHE KADASTRES LIDHUR ME TË HYRAT VETANAKE .....	47
2.3.	PAGAT DHE PERSONELI.....	48
2.3.1.	NUK ËSHTË OFRUAR SHPJEGIM LIDHUR ME PAGAT E STAFIT POLITIK.....	48
2.4.	TË PËRGJITHSHME .....	49
2.4.1.	KOMUNA NUK KA FORMUAR KOMITETIN E AUDITIMIT .....	49

**Kategorizimi i gjetjeve të auditimit sipas nivelit të rrezikut**

<b>I lartë</b>	Veprim i konsideruar i domosdoshëm për të siguruar që komuna të mos jetë e ekspozuar ndaj rrezikut të lartë (p.sh. mungesa e ndërmarrjes së veprimeve mund të rezultojë me pasoja dhe çështje të mëdha).
<b>I mesëm</b>	Veprim i konsideruar i domosdoshëm për të shmangur ekspozimin ndaj rreziqeve domethënëse (p.sh. mungesa e ndërmarrjes së veprimeve mund të rezultojë me pasoja domethënëse).
<b>I ulët</b>	Veprim i konsideruar i dëshirueshëm dhe që do të rezultojë me kontroll të shtuar dhe që do të ofronte vlerë më të mirë për paratë e shpenzuara.

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

**1. PËRCJELLJA E ÇËSHTJEVE TË NGRITURA NË VITET PARAPRAKE**

Më poshtë kemi përfshirë rekomandimet relevante të viteve paraprake dhe një koment të shkurtër për gjendjen e tyre, duke u bazuar në informatat e marra gjatë rrjedhës së rishikimit tonë.

<b>I. SISTEMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM</b>		
<b>Vëzhgimet / Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p>1.1 Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur dobësi thelbësore në dizajnimin dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme të komunës, posaçërisht në lidhje me barazimin e të hyrave të regjistruara në departamentin e kontabilitetit dhe me departamentet e ndërlidhura .</p> <p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i lartë</p>	2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Mungesa e një kontisti tani kemi Shpallur konkurs.</p>
<p>1.2 Departamenti i kontabilitetit të Komunës nuk ka zhvilluar dhe implementuar procedurat e duhura për të kontrolluar më me efektivitet grumbullimin e pagesave nga lëshimi i licencave për biznese si dhe të hyrave nga tatimi në pronë. Bazuar në vlerësimin tonë lidhur me procedurat e kontrollit të brendshëm ne kemi gjetur se departamenti i kontabilitetit nuk mban regjistra dhe regjistrime të duhura, të mjaftueshme, të detajuara apo të rregullta të borxhlinjve të saj.</p> <p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i lartë</p>	2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Ne kemi kontabilist tani në këtë Vitë do ta pranojmë.</p>
<p>1.3 Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur dobësi thelbësore në dizajnimin dhe efektivitetin e funksionimit të kontrolleve të brendshme të komunës, posaçërisht në lidhje me regjistrimin e rregullt dhe pagesave të shpenzimeve.</p> <p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i lartë</p>	2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Mungesa e një kontisti nuk ka regjistrim të rregullt për pagesa dhe shpenzime.</p>

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

<b>II. RAPORTIMI FINANCIAR</b>		
<b>Vëzhgimet/Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p>2.1 Pasqyrat Financiare të Komunës të siguruara për këtë raport janë të pakompletuara dhe nuk janë në përputhshmëri me ligjet dhe rregullat e aplikuara. Prandaj ne nuk kemi mundur të fitojmë siguri të mjaftueshme mbi përshtatjen e informatave financiare të bartura në pasqyrat financiare të Komunës.</p> <p>Dallimet në mes të pasqyrave dhe shënimeve ngrisin dyshime nëse burimi i informacionit që është përdorur nga komuna është i besueshëm.</p> <p>Në i rekomandojmë menaxhmentit të komunës që gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të përdorin burime të besueshme të informacionit dhe të shënimet e pasqyrave të jenë të barazuara me pasqyrat.</p> <p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i lartë</p>	2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Pasqyrat financiare përgaditen në bazë të një dhe të vetëm raport të shpenzimeve të thesarit.</p>
<b>III TË HYRAT</b>		
<b>Vëzhgimet/Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p>3.1 Nuk ka barazime të të hyrave ndërmjet Komunës dhe Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare nuk janë të barazuara me të dhënat nga Departamenti i Thesarit.</p> <p>Ne rekomandojmë menaxhmentin e komunës të beje barazimin e të hyrave vetanake me departamentin e Thesarit të paktën çdo tre muaj.</p> <p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i lartë</p>	2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Ne kemi dëshmi mbi barazimet me Thesarin për çdo tre muaj:  Janar-Mars 20.04.2010  Janar-Qershor 20.07.2010  Janar-Shtator 19.10.2010  Janar-Dhjetor 20.01.2010</p>

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

<b>III TË HYRAT</b>		
<b>Vëzhgimet/Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p><b>3.2</b> Nuk ka proces të barazimit ndërmjet departamenteve të cilat mbledhin të hyrat vetanake si: Departamenti i tatimit ne Prone, Departamenti i Gjeodezisë, Departamenti i Urbanizimit, etj. Dhe Departamentit të Financave dhe Buxhetit, departament i cili ka qasje ne FreeBalance dhe është përgjegjës për barazimet e ndryshimeve që mund të dalin ndërmjet të dhënave të Komunës dhe të FreeBalancit.</p> <p>Mungesa e barazimeve të rregullta mund të qoje deri të mos identifikimi i gabimeve ne kohe të duhur dhe veprimet korrigjuese do të zbatohen vështirë.</p> <p>Ne rekomandojmë Komunën të krijoje një proces të rregullt të barazimit ndërmjet departamenteve që mbledhin të hyrat dhe Departamentit të Financave dhe Buxhetit.</p>	<p>2008 2009</p>	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Kemi filluar se zbatuari në këtë vitë.</p>
<b>Klasifikimi i rrezikut</b>		
Rreziku i lartë		

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

<b>IV. MENAXHIMI I PRONËS</b>		
<b>Vëzhgimet/Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p>4.1 Komuna nuk mban regjistër të ndarë për pasurit fikse të saj në të gjitha departamentet. Gjithashtu, nuk janë bërë barazime në librat e komunës me numërimet fizike të pasurisë.</p> <p>Ne i rekomandojmë menaxhmentit të dizajnojë dhe implementojë procedura të duhura të cilat kërkojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistrim të detajuar të pronës për secilin pasuri.</li> <li>- Të caktohet dhe të fiksohet numri i identifikimit të pronës për secilin aset.</li> <li>- Politikë të kapitalizmit sipas së cilës pagesat vetëm deri në një shumë të caktuar mund të bëhen në para të gatshme.</li> </ul> <p>Gjithashtu së paku, libri i pasurive duhet të përmbajë informatat në vijim për secilin mjet themelor:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Datën e blerjes, lokacionin,</li> <li>- Numrin e caktuar nga komuna (numrin e etiketës), numrin serik,</li> <li>- Përshkrimin dhe funksionimin, bazën e kostos</li> <li>- Detajet e zhvlerësimit, përfshirë metodat e llogaritjes për qëllime të tatimit dhe raportimit financiar.</li> <li>- Kohën e vlerësuar të përdorimit.</li> <li>- Koston e mirëmbajtjes pas datës së blerjes.</li> </ul> <p>Gjithashtu me qëllim të mbajtjes dhe sigurimit të duhur të pasurisë, menaxhmenti i komunës duhet të bëjë rregullisht dhe së paku një herë në vit verifikimin fizik e të gjitha njësive të pronës. Regjistrimet përkatëse të kontabilitetit duhet të barazohen me rezultatet e këtyre numërimeve.</p> <p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i lartë</p>	<p>2008</p> <p>2009</p>	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigja e menaxhmentit</b></p> <p>Nuk ka zyrtar për asete.</p>

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

<b>V. PAGAT DHE STAFI</b>		
<b>Vëzhgimet/Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p>5.1 Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur se dosjet e personelit nuk janë complete. Aty mungojnë shpalljet e konkurseve ne gazete, mungon lista e ngushte të kandidatëve të ftuar ne interviste, referencat e tyre dhe përshkrimi i vendit të punës, mungon CV e të punësuarit, kontratat nuk janë të përditësuara sipas ndryshimeve të fundit, etj.</p> <p>Ne rekomandojmë Menaxhmentin e Komunës që të aplikojë dispozitat e Udhëzimit Administrativ MSHP/DASHC 2003/01.</p>	2008 2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Publikime të konkursit ka patur vetem në Arsim dhe shendetësi Seleksionim të listes nuk kemi bërë sepse numri i apikuesve ka qene i vogel dhe të gjithë janë ftuar në intervistë.  Publikimet kan ndodhur në gazeten Lajm me datat: 3.08.2010  22.12.2010.</p>
<p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i ulet</p>		
<p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rreziku i ulet</p>		
<p>Ne te gjitha dosjet e personelit mungon CV per te gjithë punetoret, shpallja e konkursit ne gazeta, data e shpalljes ne gazeta, si dhe theksimi I qarte e pozites. Dosjet e pakompletuara nuk jane ne pajtim me “ Managjimin e financave publike dhe pergjegjesite” Ligji 03/L-048, Seksionin 11 dhe neni 11.3</p> <p>Ne rekomandojme tek Menaxhmenti I Komunes qe te respektoje te gjitha kerkesat qe dalin nga Ligji 03/L-048.</p>	2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p>
<p><b>Klasifikimi i rrezikut</b></p> <p>Rrezik I vogel</p>		

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

<b>VI. TË PËRGJITHSHME</b>		
<b>Vëzhgimet/Rekomandimet</b>	<b>Fillimisht të raportuara</b>	<b>Statusi i implementimit për vitin 2010</b>
<p>6.1 Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se Komuna nuk ka Zyrtar për Buxhet, i cili duhet të jetë përgjegjës për projektimin e buxhetit, përcjelljen në baza mujore dhe analizimin e buxhetit përkundër shpenzimeve aktuale, dhe prezantimin e këtyre analizave Asamblesë Komunale. Gjatë vitit 2008 dhe 2009 projektimi i buxhetit dhe përcjellja e buxhetit përkundër shpenzimeve aktuale është kryer nga Drejtori i Financave Ztr. Gani Mustafa.</p> <p>Mungesa e Zyrtarit për Buxhet mund të shkaktojë planifikim jo të saktë të buxhetit dhe të shpenzimeve.</p> <p>Ne rekomandojmë menaxhmentit të komunës të punësojë ose të transferoj një punonjës që të plotësojë këtë vend pune</p>	2008	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p> <p>Tani kemi shpallur konkursë për plotësimin e kësaj pozite.</p>
<p><b>Klasifikimi i rrezikut</b> Rreziku i ulët</p>		
<p>6.2 Komuna duket të mos ketë rregull formal për ruajtjen e të dhënave. Ne kemi vëzhguar se të dhënat e brendshme të përgatitura nga kontabilistët e komunës janë të mbi-shkruara në baza mujore. Si rezultat disa komponentë të pasqyrave financiare janë të pa mbështetura. Nuk ka rregulla formale për sigurimin e qasjes me fjalëkalim për teknologjinë informative apo politika për ruajtjen e kopjeve rezervë e të dhënave. Mënyra e gjurmëve të auditimit të cilat mbështesin balancat në pasqyrat financiare është vitale për referim të mëtutjeshëm, për qëllime hulumtuese dhe në rast të pyetjeve të ndryshme. Gjithashtu është kërkesë që librat dhe shënimet adekuate të mbahen dhe të ruhen. Të dhëna të rëndësishme mund të humbin në rast se nuk bëhen rregullisht kopje rezervë e të dhënave të teknologjisë informative.</p> <p>Shënime të plota të cilat mbështesin pasqyrat financiare duhet të ruhen në mënyrë që të sigurojnë informata të mjaftueshme dhe besueshme.</p> <p>Procedurat për sigurinë e të dhënave dhe krijimin e kopjeve rezervë të informatave të teknologjisë informative duhet të jenë të specifikuara dhe implementuara.</p>	2008 2009	<p>Nuk është implementuar.</p> <p><b>Përgjigjja e menaxhmentit</b></p>
<p><b>Klasifikimi i rrezikut</b> Rreziku i mesëm</p>		

## **2. ÇËSHTJET E IDENTIFIKUARA GJATË AUDITIMIT TË VITIT AKTUAL**

### **2.1. RAPORTIMI FINANCIAR**

#### **2.1.1. DIFERENCAT NË MES TË PASQYRAVE DHE SHËNIMEVE NË PASQYRA**

##### **Vëzhgim**

Gjatë auditimit tonë, ne kemi identifikuar shumë diferenca të pa-barazuara të cilat janë regjistruar në Seksionin 9 dhe Seksionin 10 të Pasqyrave dhe shënimeve në këto Pasqyra për fund vitin 31 Dhjetor 2010.

*Seksioni 9: Pasqyra e pranimeve dhe pagesave me para të gatshme dhe diferencat;*

- i. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” pranimet totale të parasë se gatshme janë të prezantuara ne Shumën EUR 942 mijë përderisa pagesat totale janë të prezantuara ne shumën prej EUR 505 mijë, duke pasur një ndryshim prej EUR 437 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- ii. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” tregon se të hyrat nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk janë të prezantuara si duhet dhe janë ne shumën prej EUR 908 mijë përderisa Shënimi 2 i Nenit 11 tregon një shumë prej EUR 1,093 mijë, duke pasur kështu një ndryshim prej EUR 185 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- iii. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” Të hyrat nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës të raportuara janë EUR 386 mijë përderisa Shënimi 5 i Seksionit 11 tregon një shumë prej EUR 488 mijë, duke pasur një diferencë prej EUR 102 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- iv. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” mallrat dhe shërbimet nuk janë prezantuar siç duhet dhe janë ne shumën prej EUR 57 mijë përderisa shënimi 6 tek Seksioni 11 tregon një shumë prej EUR 86 mijë, duke pasur një ndryshim prej EUR 29 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- v. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” komunalit e raportuara janë EUR 19 mijë përderisa Shënimi 7 i Seksionit 11 tregon një shumë prej EUR 26 mijë, duke pasur një ndryshim prej EUR 7 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- vi. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” Transferet dhe subvencionet nuk janë të prezantuara siç duhet dhe janë ne shumën zero euro, përderisa Shënimi 8 tek Seksioni 11 tregon një shumë prej EUR 8 mijë, duke pasur një ndryshim prej EUR 8 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- vii. Seksioni 9 “Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme” Investimet kapitale nuk janë prezantuar siç duhet dhe janë ne shumën prej EUR 42 mijë përderisa Shënimi 9 i Seksionit 11 tregon një shumë prej EUR 308 mijë, duke pasur një diferencë prej EUR 266 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009.
- viii. Seksioni 10 “ Pasqyra mbi Ekzekutimin e Buxhetit” shuma aktuale e të hyrave ne para të gatshme ne konton e thesarit janë ne shumën prej zero Euro, përderisa shumë aktuale e pagesave me para të gatshme janë ne shumën prej EUR 926 mijë, duke pasur një diferencë prej EUR 926 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009.
- ix. Seksioni 10 “ Pasqyra mbi Ekzekutimin e Buxhetit” pagesat për stafin dhe shpenzimet për shujta të raportuara janë EUR 488 mijë përderisa Shënimi 17 i Seksionit 11 nuk është i shpalosur; duke pasur një ndryshim prej EUR 488 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009.

**KOMUNA E NOVOBËRDËS**  
**SHTOJCA 1 – LETËR PËR MENAXHMENTIN**  
**Për fund vitin 31 Dhjetor 2010**

---

**2.1.1. DIFERENCAT NË MES TË PASQYRAVE DHE SHËNIMEVE NË PASQYRA (VAZHDIM)**

- x. Seksioni 10 “ Pasqyra mbi Ekzekutimin e Buxhetit” pagesat për mallra dhe shërbime të raportuara janë EUR 92 mijë përderisa Shënimi 18 i Seksionit 11 nuk është i shpalosur, duke pasur një ndryshim prej EUR 92 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- xi. Seksioni 10 “ Pasqyra mbi Ekzekutimin e Buxhetit” pagesat për shpenzimet komunale të raportuara janë EUR 26 mijë përderisa Shënimi 19 i Seksionit 11 nuk është i shpalosur, duke pasur një ndryshim prej EUR 26 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- xii. Seksioni 10 “ Pasqyra mbi Ekzekutimin e Buxhetit” Transferet dhe subvencionet e raportuara janë EUR 9 mijë përderisa Shënimi 20 i Seksionit 11 nuk ehte i shpalosur, duke pasur një ndryshim prej EUR 9 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009;
- xiii. Seksioni 10 “ Pasqyra mbi Ekzekutimin e Buxhetit” pagesat për investimet kapitale të raportuara janë EUR 311 mijë përderisa Shënimi 21 i Seksionit 11 nuk është i shpalosur, duke pasur një ndryshim prej EUR 311 mijë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009.

**Ndikimi**

Dallimet në mes të pasqyrave dhe shënimeve rrisin dyshime nëse burimi i informacionit që është përdorur nga komuna është i besueshëm.

**Rekomandim**

Në i rekomandojmë menaxhmentit të komunës që gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të përdorin burime të besueshme të informacionit dhe të shënimet e pasqyrave të jenë të barazuara me pasqyrat.

**Klasifikimi i rrezikut**

Rreziku i lartë

**Përgjigjja e menaxhmentit:**

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare përdorim informacionet dhe shenimet e FREEBALANCIT.

## **2.2. TË HYRAT**

### **2.2.1 SHUMAT MBI 10 EURO JANE MBLEDHUR SI PARA TË GATSHME NGA ZYRTARI I TË HYRAVE I KOMUNES**

#### **Vëzhgim**

Gjate auditimit tone ne kemi vërejtur se Zyrtari i të Hyrave të Komunës ka bere pranimin e pagesave ne para të gatshme ne shuma me të larta se 10 Euro për pagesat e bëra nga qytetaret ne emër të shërbimeve të Komunës sikurse tatimi ne prone, taksa për pjesëmarrje ne tender, etj. Të hyrat e mbledhura ne fund të ditës apo ditën e ardhshme janë depozituar ne xhirollogarinë e Komunës ne Bankën Qendrore të Kosovës.

#### **Ndikimi**

Kjo praktikë paraqet shkelje të nenit 8.3 të Rregullores Financiare 03/2010 mbi të Hyrat lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe e cila qartë thekson se zyrtari i mbledhjes se të hyrave që ka qasje ne sistemin SIMFK (sistemi i Free Balancit) nuk mund të jete mbledhës i parave publike dhe nuk duhet trajtuar fizikisht paratë publike të mbledhura nga organizatat buxhetore.

Për me tepër, kjo praktike paraqet gjithashtu shkelje të rregullores se Komunës mbi taksat dhe gjobat e miratuar nga Kuvendi Komunal i cili thekson se të gjitha pagesat mbi EUR 10 duhet të bëhen nëpërmjet xhirollogarisë bankare.

#### **Rekomandim**

Ne rekomandojmë Menaxhmentin e Komunës të caktojë një tjetër zyrtar, tjetër nga zyrtari i të hyrave, i cili do të bënte mbledhjen e pagesave ne para të gatshme dhe gjithashtu të sigurohej që asnjë pagese mbi EUR 10 të mos mblidhet ne para të gatshme nga personeli i Komunës.

#### **Klasifikimi i rrezikut**

Rreziku i lartë

#### **Përgjigjja e menaxhmentit:**

Në teritorin e komunës së Novobërdës nuk ka as një bank komerciale, distanca nga selia e komunës së Novobërdës deri të një bank komerciale është Gjilani në një drejtim 20 Km.

**2.2.2. MUNGESA E DOKUMENTACIONIT LIDHUR ME TË HYRAT PER ÇERTIFIKATAT  
E LESHUARA TË REGJISTRIMIT CIVIL NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS**

**Vëzhgim**

Gjate auditimit tone të të hyrave vetanake nga zyra e certifikatave të regjistrimit civil ne Departamentin e Administratës ne nuk ishim të kënaqur lidhur me tërësinë e këtyre të hyrave. Arsyeja për këtë është që, edhe pas disa tentimeve, neve nuk na është ofruar dokumentacioni mbështetës i plote dhe i kënaqshëm lidhur me të hyrat vetanake të gjeneruara nga Departamenti i Administratës.

**Ndikimi**

Për shkak të faktit se neve nuk na është ofruar dokumentacioni mbështetës nga Departamenti i Administratës ne nuk ishim të kënaqur lidhur me tërësinë e të hyrave vetanake që mblidhen nga Departamenti i Administratës.

**Rekomandim**

Ne rekomandojmë Menaxhmentin e Komunës të sigurohet që të gjitha certifikatat e lëshuara nga zyra e Regjistrimit Civil e Departamentit të Administratës janë të llogaritura dhe këto të hyra janë të regjistruara si duhet dhe të njohura si të hyra ne Buxhetin e Komunës.

**Klasifikimi i rrezikut**

Rreziku i lartë

**Përgjigjja e menaxhmentit:**

Punëtorët e angazhuar në këtë departament për ditët e hospitimit kanë qenë në pushime festave të komunitetit serb.

**2.2.3. MUNGESA E DËSHMIVE TË MJAFTUESHME TË MBAJTURA NGA  
DEPARTAMENTI I URBANIZIMIT DHE KADASTRES LIDHUR ME TË HYRAT  
VETANAKE**

**Vëzhgim**

Gjate auditimit të të hyrave vetanake nga Departamenti i Urbanizmit dhe Kadastrës ne kemi identifikuar që ky departament nuk mbanë një regjistër të përshtatshëm për të gjitha certifikatat e lëshuara dhe kështu edhe të gjitha të hyrat e njohura ne buxhetin e Komunës nga ky departament.

Për shkak të mungesës së këtyre dokumenteve ne nuk ishim të kënaqur lidhur me terësinë e të hyrave vetanake të gjeneruara nga Departamenti i Urbanizmit dhe Kadastrës të Komunës së Novobërdës.

**Ndikimi**

Mungesa e dëshmive përkatëse lidhur me të gjitha certifikatat e lëshuara mund të qojë në nënvlerësimin e të hyrave të gjeneruara nga ky Departament.

**Rekomandim**

Ne rekomandojmë Menaxhmentin e Komunës të sigurohet që të gjitha certifikatat e lëshuara nga Departamenti i Urbanizmit dhe Kadastrës janë të llogaritura dhe që të hyrat përkatëse janë të regjistruara në mënyrë të duhur dhe janë të njohura si të hyra në buxhetin e Komunës.

**Klasifikimi i rrezikut**

Rreziku i lartë

**Përgjigjja e menaxhmentit:**

Do të fillojmë nga ky vitë së zbatuari.

### **2.3. PAGAT DHE PERSONELI**

#### **2.3.1. NUK ËSHTË OFRUAR SHPJEGIM LIDHUR ME PAGAT E STAFIT POLITIK**

##### **Vëzhgim**

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar se pagat e stafit politik në komunë, duke përfshirë: kryetarin, zëvendës kryetarët e komunave, kryesuesit dhe zëvendës kryetarët e Kuvendit Komunal nuk janë disbursuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ 16-2008 mbi Pagesat e Stafit Politik në Komuna. Sipas këtij udhëzimi paga e kryetarit të komunës duhet të jetë 900 Euro ngaqë Kuvendi Komunal Novobërdë ka më pak se 21 anëtarë. Megjithatë paga aktuale është 990 Euro ose 10% më e lartë dhe gjithashtu edhe pagat e zëvendës kryetarëve të komunave dhe kryetarit dhe zëvendës kryetarëve të Kuvendit Komunal janë për 10% më të larta se sa duhet të jenë. Ne nuk kemi marrë ndonjë shpjegim të mjaftueshëm në lidhje me këto ndryshime.

##### **Ndikimi**

Pagesat e rrogave më të larta se ato të autorizuar sipas Udhëzimit Administrativ 16-2008 përfundojnë në mbivlerësim të shpenzimeve të pagave për Komunën, dhe për më tepër nuk është në përputhje me Udhëzimin Administrativ 16-2008 mbi Pagesat e Stafit Politik në Komuna.

##### **Rekomandim**

Komuna duhet të sigurojë që kompensimi për të gjithë stafin e tij është i bazuar në ligjet e aplikueshme dhe Udhëzimeve Administrative të cilat janë aktualisht në fuqi në Republikën e Kosovës.

##### **Klasifikimi i rrezikut**

Medium risk.

##### **Përgjigjja e menaxhmentit:**

Rritja e pageve për stafin politik ka ndodhur në vitin 2009

## **2.4. TË PËRGJITHSHME**

### **2.4.1. KOMUNA NUK KA FORMUAR KOMITETIN E AUDITIMIT**

#### **Vëzhgim**

Komuna ka formuar Komitetin e Auditimit sikurse kërkohet nga neni 6 paragrafi 2 i ligjit Nr. 03/L-128 mbi Auditimin e Brendshëm të organizatave publike, ne vend të kësaj auditor i brendshëm i raporton drejtpërdrejt Kryetarit të Komunës.

#### **Ndikimi**

Ekziston rreziku që mund të ketë konflikt të interesit ndërmjet auditorit të brendshëm dhe kryetarit, si dhe pavarësia profesionale e auditorit të brendshëm mund të rrezikohet.

#### **Rekomandim**

Ne rekomandojmë Menaxhmentin e Komunës të krijojë një komitet të Auditimit përmes të të cilit rekomandimet e Auditorit të Brendshëm do të komunikohen dhe ndiqen.

#### **Klasifikimi i rrezikut**

Rreziku i lartë

#### **Përgjigjja e menaxhmentit:**

Do ta formojmë!

## **SHTOJCA 2**

### **Format e Opinioneve të ndryshme sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit “SNA”**

#### **Opinionit i kualifikuar**

Opinionit i pakualifikuar duhet të shprehet kur auditori konkludon se pasqyrat financiare janë të prezantuara drejt, në të gjitha aspektet materiale, në ë përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Numër 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i cili përcakton që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (“IPSAS”), “Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme”.

#### **Paragrafi i theksimit të çështjes**

Ne kushtet e caktuara, opinionit i auditorit mundë të modifikohet duke e shtuar paragrafin theksimit të çështjes që të theksojmë çështjet të cilat ndikojnë në pasqyrat financiare të cilat shqyrtohen në detaje në shënimet e pasqyrave financiare. Shtesa e këtij lloj paragrafi nuk ndikon në opinionin e auditorit. Paragrafi zakonisht do të shtrohet pas paragrafit të opinionit të auditorit por para paragrafit të ndonjë përgjegjësie tjetër të raportimit, nëse ka ndonjë. Paragrafi i theksimit të çështjes do të duhet të referohet zakonisht që opinionit i auditorit nuk është i kualifikuar për këtë çështje.

#### **Opinionit i Kualifikuar**

Opinionit i kualifikuar duhet të shprehet atëherë kur auditori konkludon se opinionit i pakualifikuar nuk mund të shprehet por që efekti i çfarëdo mospajtimi me menaxhmentin, apo kufizim fushëveprimi nuk është material dhe përhapur që të kërkojë opinion të kundërt apo mohim të opinionit. Opinionit i kualifikuar duhet të shprehet si “përveç” efekteve të çështjes për të cilat kualifikimi është.

#### **Mohim i Opinionit**

Mohim i opinionit duhet të shprehet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit të fushëveprimit është aq material dhe i përhapur që auditori nuk ka pasur mundësi të sigurojë evidencë të duhur dhe të mjaftueshme dhe si pasojë nuk është në gjendje të shpreh opinion për pasqyrat financiare.

#### **Opinionit i Kundërt**

Opinionit i Kundërt duhet të shprehet atëherë kur efekti i mospajtimit është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare që auditori konkludon që kualifikimi i raportit nuk është adekuat që të shpалosim informatën çorientuese apo të paplotë në natyrën e pasqyrave financiare.